



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 12 dhjetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi.

Mungoi: Shaip Muja, Sabri Hamiti e Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Dervishi, Besarta Zuka – NDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja mbajtur më 26 nëntor 2012;
3. Diskutim për punën e Komisionit gjatë këtij viti;
4. Iniciativa për konferencën me komisionet e jashtme parlamentare të rajonit;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalit nga e mbledhja e mbajtur, më 26 nëntor 2012.

3. Diskutim për punën e Komisionit gjatë këtij viti;

Albin Kurti diskutoi për punën e bërë në Komision gjatë këtij viti dhe angazhimet e Komisionit në përmbushjen e obligimeve të parapara me Planin dhe programin e tij të punës. Ai theksoi se Komisioni gjatë këtij viti kryesisht ka mbajtur dy takime në muaj, dhe ka bërë përpjekje që në masë

të madhe ta përmbushë programin e punës për këtë vit. Përmendi çështjet e shqyrtuara në Komision dhe çështjet të cilat nuk kanë arritur të realizohen gjatë këtij viti. Komisioni për punën e vet, në fund të këtij viti kalendarik tha se do të hartoj raportin e punës, i cili do të diskutohet e miratohet në Komision. Ftoi anëtarët e Komisionit për ndonjë sugjerim apo vërejte në punën e Komisionit të bërë gjatë këtij viti.

Hydajet Hyseni lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se stafi është mirë të përgatitë një draft të aktiviteteve të Komisionit të cilat ne pastaj në një nga mbledhjet e ardhshme mund t'i shqyrtojmë, në mënyrë që mos të improvizojmë gjithë aktivitetet e Komisionit. Njoftoi se në mungesë të kryetarit të Komisionit, është takuar me ekspertë të projektit që mbështesin punën e Kuvendit dhe se është angazhuar që të ketë për secilin komision staf të veçantë, ngase nuk i mbështet praktikat që i njëjti koordinator, të jetë për dy komisione. Po ashtu theksoi se komisionet kanë nevojë për mbështetje profesionale dhe juridike dhe se Komisioni ynë nuk e ka asnjërën.

Albin Kurti tha se raporti i punës do të bëhet në bashkëpunim me stafin pas përfundimit të aktiviteteve gjatë këtij viti dhe nëse ndonjë nga anëtarët e Komisionit ka për të shtuar ndonjë plotësim apo sugjerim, do të mund të përfshihej në raport.

4. Iniciativa për konferencën me komisionet e jashtme parlamentare të rajonit;

Albin Kurti lidhur me organizimin e konferencës tha se një draft i ftesës për pjesëmarrësit në konferencë është punuar nga eksperti i tanishëm nga NDI, Blerim Dervishi, i cili në aspektin profesional e mbështetë Komisionin.

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me iniciativën për konferencën me komisionet e jashtme parlamentare të rajonit, me theks të veçantë për emërtimin e saj, kohëzgjatjen, temat e diskutimit dhe për të ftuarit.

Pas diskutimeve të deputetëve, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

-Të organizohet tryeza e rrumbullakët rajonale e komisioneve për punë të jashtme me temën: "Bashkëpunimi rajonal, integrimi evropian dhe roli i diplomacisë parlamentare".

-Tryeza të organizohet më 11 mars 2013, në ndërtesën e Kuvendit, me përfaqësues të komisioneve të jashtme nga: Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Hungaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Shqipëria, Sllovenia, Turqia dhe deputetë nga Parlamentit Evropian.

-Qëndrimi i delegacionit të përfaqësuesve të komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit në Prishtinë, të jetë nga dt. 10 – 12 mars 2013, përkatësisht arritja më 10 mars dhe përcjellja e delegacionit më 12 mars 2013.

6. Të ndryshme

Albin Kurti lidhur me mbledhjen e mbrëmshme të mbajtur në Bruksel, tha se kishte qenë mirë që konkluzionet e nxjerra për Kosovën, të diskutohen në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

Skender Hyseni tha se e përkrah idenë e z. Hydajet Hyseni, për nevojën që ka Komisioni për një ekip të veçantë, i cili do të duhej ta përkrahte Komisionin, duke e furnizuar me materiale, me çdo gjë që ndodhë dhe që ka të bëjë në mënyrë direkte apo indirekte me këtë Komision. Për sa është i informuar nga mediet tha se ka mjaftë kushtëzime për Kosovën dhe se shtyrja e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit deri në qershor, paraqet një shqetësim serioz për Kosovën .

Theksoi se Komisioni do të duhej të diskutonte sot për konkluzionet që janë nxjerrë në Bruksel për Kosovën, diskutimi i tyre në mbledhjen e ardhshme do të ishte i vonshëm dhe jo serioz. Propozoi që herëve të tjera për ngjarje të tilla të rëndësishme për Kosovën, Komisioni të jetë më i kujdesshëm, t'i diskutojë këto ngjarje dhe të dalë me ndonjë qëndrim.

Hydajet Hyseni theksoi se është mirë që Komisioni në çdo mbledhje të ketë një hapësirë për diskutim kolegial sa i përket ngjarjeve ku përfshihet Kosova. Informoi Komisionin se gjatë dy ditëve në vijim, do të ketë një pjesëmarrje së bashku me deputetin Sabri Hamiti në Komisionin për demokratizim dhe të drejta të njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, që është vazhdimësi e një komunikimi të më hershëm. Propozoi që kryetari së bashku me stafin, të mundësojnë komunikimin dhe kontaktet me përfaqësuesit e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që me ata të bisedohet këtu, që të mos ketë nevojë të shkohet jashtë. Çështje tjetër me rëndësi tha se është nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Kosovës, pa u shqyrtuar asnjëherë nga ana e Komisionit.

Albin Kurti kërkoi nga eksperti Blerim Dervishi që ta hulumtojë agjendën e Brukselit dhe duke pasur parasysh planin e tyre të takimeve, të planifikohet mbajtja e mbledhjeve të Komisionit. Theksoi se, në Bruksel thuhet se bisedimet e vërteta do të jenë në vitin tjetër, prandaj Komisioni në vitin e ardhshëm duhet të jetë më aktiv dhe të kërkojë llogaridhënie për atë se çfarë do të bisedohet në Bruksel.

Takimi përfundoi në orën 12 :00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti